



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më
Dana

04-10-2017

P.nr.854/2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahim, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga [REDACTED], Rr.” [REDACTED]”, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.353-3/17 të dt. 05.04.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.28.08.2017 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.353-3/17 të dt. 05.04.2017 dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga [REDACTED], Rr.” [REDACTED]”, i lindur me datë, [REDACTED], nga i ati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal [REDACTED], mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 25 shkurt 2017, rreth orës 10:15, në magjistralen Kaçanik - Prishtinë, me të arritur në Ferizaj, përball restorant “Evropa 92”, duke drejtuar automjetin e tipit “Scania”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit [REDACTED], nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që ka shkel nenin 53 par 1 dhe 54 par 1 pika 1.2 të ligjit mbi komunikacionin rrugor, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës në vendbanim, si dhe duke mos e mbajtur distancën e nevojshme nga mjete i cili lëviz përpara aq sa është e nevojshme për t’iu shmangur goditjes së mjetit nëse i njëjti frenon apo ndalet për pasojë në momentin kur i del një automjet, i tipit “Mercedes”, në pamundësi për tu ndalur kalon jashtë rrugës në anën e djathtë në parking të restorantit dhe me këndin e majtë të përparme e godet në anësoren e djathtë automjetin e tipit “Audi”, ngjyrë hiri, me targa [REDACTED], pronë e të dëmtuarit [REDACTED], i cili ishte e ndalur në parking, ku përveç dëmeve materiale l dëmtuari i lart cekur pëson lëndime të lehta trupore.

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarin: [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale 60.88€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.353-3/17 të dt. 05.04.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], Rr." [REDAKTUAR] ", për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjegjësishtë konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i dt.29.03.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 26.03.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin: [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.854/2017 i dt.28.08.2017

Zyrtare Ligjore

Lavdiye Brahim

Gjyqtari

Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.